



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR. 1413 AKTI

VENDIM

“Ne Emer te Republikes”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

GJYQTAR: Petrit ÇOMO

GJYQTARE: Ardiana BERA

GJYQTARE: Klorinda ÇELA

Asistuar nga sekretarja gjyqesore Ina XHAFERI, me pjesemarrjen e prokurores Suela SALAVAÇI, nga data 24.11.2016, deri sot, ne daten 21.12.2016, ne Tirane, mori ne shqyrtim ne disa seanca gjyqesore publike kerkesen penale Nr. 1413 akti, qe i perket:

KERKUES: I. S., i biri i B.t, dtl. 24.10.19.., lindur ne Arakli, Turqi, banues ne Turqi, me vendqendrim ne Tirane, Rr. ..., beqar, me arsim te larte, me kombesi dhe shtetesi turke, perfaqesuar ne gjykim nga av. Artan Kodheli, me licence nr. 833, me prokure te pergjithshme nr. ... rep., nr.... kol., dt. 01.07.2015, te noteres Anila Gjermeni.

OBJEKTI: Kundershtim i vendimit te prokurorise dt. 27.07.2015, per sekuestrimin e sendeve dhe lenien ne ruajtje te tyre.

BAZA LIGJORE: Nenet 212, 301 e vijues te KPPenale.

Gjykata pasi mori provat, degjoi avokatin e kerkuesit, i cili ne perfundim te gjykimit kerkoi pranimin e kerkeses, prokuroren, e cila kerkoi rrezimin e kerkeses, si e shqyrtoi çeshtjen ne teresi:

VEREN

Se ne daten 03.08.2015 kerkuesi i eshte drejtuar gjykates me kete kerkese, me ane te se ciles kundershon vendimin e prokurores Suela Salavaçi dt. 27.07.2015, per sekuestrimin e sendeve dhe lenien ne ruajtje.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi se me prokuren e pergjithme nr.... rep., nr. ... kol., dt. 01.07.2015, te noteres Anila Gjermeni, avokati Artan Kodheli eshte caktuar perfaqesues ligjor i shtetasit turk I. S.. Disa kohe para se t'i drejtohej gjykates, ai ka rene ne dijeni te faktit se ndaj shtetasit I. S. ishte regjistruar procedimi penal nr. 2976, viti 2015, per akuzen e parashikuar nga neni 180 i KPenal. Ne daten 08.07.2015 avokati i ishte drejtuar organit te prokurorise te rrethit Tirane, qe ne baze te nenit 105 te KPenale dhe ligjit per avokatine, ti viheshin ne dispozicion aktet procedurale mbi te cilat kishte filluar ky procedim penal. Nga ana e prokurorise nuk i ishte dhene asnje informacion. Ne daten 30.07.2015 avokati eshte vene ne dijeni nga shtetasi I. S. se ne kete date tre oficer te policise gjyqesore te prokurorise se rrethit Tirane, kane sekuestruar prane personit fizik I. S. me NIPT L 4...5 O makinerite e ketij subjekti, duke ia lene ato ne ruajtje shtetasit S. A.. Sipas kerkuesit shtetasit I. S. dhe S. A. kane qene ortake te shoqerise U... S... LTDme raporte I. S. 50% te aksioneve, S. A. 25 % te aksioneve, ndersa administrator i shoqerise ka qene S. A.. Kjo shoqeri aktualisht nuk funksionon per shkak te mosmarreveshjeve civile qe kane midis tyre subjektet. Shoqeria eshte pasive dhe nga administratori S. A. eshte penguar mbyllja e shoqerise. I. S. eshte detyruar qe te regjistroje nje person fizik dhe te ushtroje veprimtarine e tij ne nje ambient te marre me qera. Vendimi per sekuestrimin e makinerive te veprimtarise te shtetasit I. S. dhe lenia e tyre ne ruajtje shtetasit S. A. eshte nje veprim i pambeshtetur ne ligj nga ana e prokurorise, sepse me kete vendim prokuroria ka zgjidhur konfliktin civil midis paleve. Me kete vendim organi i prokurorise ka pezulluar veprimtarine e subjektit fizik I. S., duke marre kompetencat e gjykates, kur kjo e fundit eshte i vetmi institucion qe ligji i jep te drejten e zgjidhjes se perkohshme apo te perhershme te konflikteve civile qe mund te kene ortaket e nje shoqerie tregtare ne Republiken e Shqiperise. Ka ligje te posaçme si ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe KPCivile, qe rregullojne dhe caktojne menytrat e zgjidhjes te pretendimeve qe ortaket apo te tretet kane me nje shoqeri tregtare. Prokuroria duke i hequr makinerite njerit subjekt dhe duke ja lene tjetrit, ka marre tagrat e gjykates per zgjidhje civile te konfliktit midis ortakeve te shoqerise tregtare. Kjo e ben kete vendim te prokurorise nje akt administrativ absolutishte te pavlefshem, pasi eshte jashte kompetences se saj lendore. Vendimi i prokurorise bie ne kundershitim me vete arsyetimin qe i eshte bere. Ne paragrafin e fundit pretendohet se keto makineri te pasqyruara ne faturen e detajuar e cila i bashkengjitet fatures tatimore te shitjes jane te blera nga I. S.. Pra keto makineri qe jane prone e tij, perse duhet te lihen ne ruajtje te dikujt tjetër? Perse prokuroria pengon veprimtarine prodhuese te ketij subjekti ? Duke qene se ky subjekt ka mardhenie tregtare me subjekte te tjera , kush do ta paguaje demin e shkakuar nga nderprerja e punes ? Sipas avokatit vendimi i prokurorise bie ne kundershitim me nenin 208/1 te KPPenale qe i referohet, pasi duke iu referuar akuzes qe parashtrohet, fshehja e te ardhurave, duhet ta argumentoje me vendim te arsyetuar perse keto sende jane prova materiale qe lidhen me vepren penale dhe perse duhet t'i ruaje shtetasi S. A.. Çfare lidhje kane lavatriçet e larjes se rrobave, kompresori, makina e tharjes, etj., me vepren penale te fshehjes te te ardhurave? Edhe po te supozohet se organi i akuzes pretendon se nga hetimi do te dale qe I. S. ka fshehur te ardhura dhe keto makineri duhen per te garantuar demin civil, atehere mund te sekuestroheshin dhe t'i liheshin ne ruajtje pronarit I. S., ashtu si veprohet ne shume raste te tjera.

Ne perfundim te kerkeses avokati ne emer te kerkuesit ka kerkuar shfuqizimin e vendimit te prokurorise dt.27.07.2015, te çeshtjes 2976/2015, per sekuestrimin e sendeve dhe lenien ne ruajtje.

Gjykimi ka filluar ne seancen e pare dt. 07.09.2015, me pranine e perfaqesuesit te kerkuesit me prokure te pergjithshme nr.... rep., nr.... kol., dt.01.07.2015, te noteres Anila Gjermeni, av. Artan Kodheli. Nga e seanca e dyte e dates 10.09.2015 e ne vazhdim, kerkuesi eshte perfaqesuar ne gjykim nga av. Ramiz Billa, me prokure te posaçme nr. ... rep., nr. ... kol., dt. 10.09.2015, te noteres Romina Meli. Kjo prokure nuk eshte nenshkruar nga kerkuesi I. S., por nga perfaqesuesi i tij E. P.. Jane zhvilluar disa seanca gjyqesore, ku palet kane dhene shpjegimet e tyre dhe jane marre provat e kerkuara. Ne seancen e fundit te dates 29.09.2015, av. Ramiz Billa ka deklaruar se terheq ankimin dhe kerkon pushimin e gjykimit te çeshtjes. Prokurorja ka deklaruar se eshte dakord me kete kerkese. Ne keto kushte gjykata ne baze te neneve 276, 278 dhe 286 te KPPenale ka vendosur pushimin e gjykimit.

Duke mos qene dakord me kete vendim, kerkuesi brenda afatit ligjor, me ane te avokatit te tij me prokure Artan Kodheli, ka bere ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane, kunder vendimit te gjykates se rrethit gjyqesore Tirane.

Me vendimin nr. 1201, dt. 05.10.2016, te Gjykates se Apelit Tirane eshte prishur vendimi nr. 1077 akti, dt. 29.09.2015, i Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane dhe eshte derguar çeshtja per rigjykim ne po kete gjykate me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Tirane e ka prishur vendimin e gjykates te rrethit gjyqesore Tirane me arsyetimin se avokati Ramiz Billa nuk ka patur ne prokure tager per te terhqur kerkesen dhe per te kerkuar pushimin e gjykimit. Avokati i ka tejkalar kompetencat e dhena ne prokure dhe ka vendosur ne kundërshtim me interesin e kerkuesit. Ne keto kushte sipas gjykates se apelit vendimi i gjykates se rrethit gjyqesor eshte rrjedhoje e zbatimit te gabuar te ligjit dhe per pasoje duhet te priset.

Megjese shtetasi I. S. po gjykohet aktualisht si i pandehur nga ky trup gjykues, çeshtja i eshte caktuar ketij trupi gjykues.

Fillimisht gjykata zbatoi detyrat e gjykates se apelit. Gjykimi u zhvillua me pranine e avokatit Artan Kodheli, i cili eshte perfaqesuesi ligjor me prokure i kerkuesit ne kete gjykim. Ne gjykim morri pjese gjithashtu edhe prokurorja e çeshtjes, Suela Savalaçi.

Ne gjykim avokati u qendroi pretendimeve te paraqitura si ne kerkese, ashtu edhe gjate gjykimit te meparshem ne te dyja shkallet. Sipas tij vendimi i prokurorise eshte i padrejte, i pabazuar ne ligj e si pasoje duhet te shfuqizohet nga gjykata. Organi i prokurorie ka shkelur ligjin. Nuk kuptohet pse i jane lene ne ruajtje shtetasit S. A. sendet, kur ky i fundit nuk ka lidhje fare me procedimin ne lidhje me akuzen per fshehjen e te ardhurave. Prokuroria ka marre tagrat e gjykates. Eshte nje proces hetimor qe nuk ka lidhje me lenien ne ruajtje te pronave te nje shtetasi nje shtetasi tjetër. Makinerite duhet t'i kthehen shtetasit I. S.. Megjithate avokati deklaroi se kur eshte paraqitur kerkesa ka patur emergjence, ndersa tani kerkuesi eshte demtuar nga bllokimi i makinerive per nje kohe te gjate dhe per te zgjidhur mosmarreshjet ndërmjet paleve po zhvillohet nje gjykim civil.

Prokurorja i qendroi vendimit te sekuestrimit te dates 27.07.2015. Sipas saj ky vendim eshte i bazuar ne nenet 208,214 e vijues te KPPenale. Sendet (makinerite) i jane lene ne ruajtje administratorit, pasi ndodheshin prane vendit ku ushtronte aktivitetin shoqeria.

Palet kerkuan te merren si prova ato prova qe ndodhen ne fashikullin e gjykates nr.1077 akti, dt.29.09.2015.

Sa me sipër u provuan gjatë gjykimit me provat shkresore që ndodhen në fashikullin nr.1077 akti, dt.29.09.2015, të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe me shpjegimet e paleve.

Duke u bazuar në provat e marra në gjykim, gjykata arrin në përfundimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj. Prokuroria ka vendosur në baze të nenit 208 të KPPenale, sekuestrimin e disa sendeve, pasi ka patur dyshime të arsyeshme për kryerjen e një veprë penale. Në baze të nenit 214 të KPPenale, sendet i janë lënë në ruajtje administratorit të shoqërisë U... S... I... LTD, pasi është dyshuar se I. S. ka shpërdoruar kompetencat dhe ka përvetësuar paisjet e kompanisë, si dhe dyshohet se po ato përdoren prej tij në funksion të një biznesi të ri të krijuar prej tij si person fizik. Gjithashtu ngaqë makineritë kanë qenë të renda dhe ka qenë e vështirë të levizeshin, i janë lënë në ruajtje administratorit të shoqërisë që ushtronte aktivitetin në të njëjtin vend. Përsa i përket pronesisë të këtyre makinerive, si dhe mosmarreveshjeve ndërmjet paleve, do të shprehet gjykata civile. Në kushtet kur vendimi i prokurorisë është i bazuar në nenet 208,214 e vijues të KPPenale, si dhe kur ndërmjet paleve po zhvillohet një gjykim civil për të zgjidhur mosmarreveshjet, gjykata çmon se vendimi i prokurorisë aktualisht duhet të lihet në fuqi.

Pavarësisht se vendimi i prokurorisë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, kerkuesi mund të ketë të drejtë në pretendimet e tij, pasi mund t'i jete shkaktuar dëm. Por këto pretendime, për sqarimin e të drejtave të tij, mund t'i zgjidhe në një gjykim civil, ashtu siç ka vepruar. Në këtë mënyrë kerkuesi do të realizojë të drejtat e tij, të cilat pretendon se i janë shkelur. Gjithashtu ai mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Në këtë gjykim, me objekt kundërshtim i vendimit të prokurorisë për sekuestrimin e sendeve, gjykata nuk mund të hetojë si në çështjet e themelit, nëse kerkuesi është pronar i ligjshëm i sendeve të sekuestruara apo për faktin se ato mund të jenë prone e shoqërisë së mëparshme dhe po përdoren nga ai për qëllimet e tij. Gjikata kontrollon vetëm bazueshmerinë në ligj të vendimit të prokurorisë dhe siç është përmendur edhe me lart ky vendim është i bazuar në ligj.

Për sa më sipër gjykata çmon se vendimi i prokurorisë dt. 27.07.2015, për sekuestrimin e sendeve dhe lenien në ruajtje në kuadër të procedimit penal Nr. 2976, viti 2015, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, në nenet 208,214 e vijues të KPPenale e si pasoje kërkesa e kerkuesit I. S. duhet të rrezohet si e pambeshtetur në ligj. Kerkuesi mund t'i realizojë të drejtat e tij në një gjykim civil, ashtu siç edhe ka vepruar.

PER KETO ARSYE

Gjikata në baze të neneve 208, 212 dhe 276 të KPPenale:

VENDOSI

- Rrezimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kunder këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit ligjor.
- U shpall sot, në datën 21.12.2016, në Tiranë.

GJYQTARE

GJYQTARE

GJYQTAR

Klorinda ÇELA

Ardiana BERA

Petrit ÇOMO

SEKRETARE
Ina XHAFERI